



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 22.05.2023

Nr: 120

Ora: 12:55

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 64, DATË 20.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA "PARTIA LËVIZJA E LEGALITETIT"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 22.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvin	LAKO	-	Relator
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: "Partia Lëvizja e Legalitetit"

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 15, datë 16.05.2023 të KZAZ nr. 27 Kamëz "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e këshillit bashkiak Kamëz"

BAZË LIGJORE: Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Partia "Lëvizja e Legalitetit" ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 64 regj., datë 20.05.2023.

Në mbledhjen e datës 22.04.2023, ora 12:55, pas relatimit të z. Elvin Lako, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 64 nuk i plotësonte kërkesat e nenit 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

KAS vihet në lëvizje nga subjektet me të drejtën e tyre për ankim ndaj vendimit për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve në zonën zgjedhore. Kërkesa nr. 64, është regjistruar në KQZ në datën 20.05.2023 në orën 12:15, para marrjes së vendimit nr. 536, nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023", i cili është marrë në datën 20.5.2023, ora 19:00.

Në këto rrethana, kërkesa ankimore është pa objekt të ligjshëm dhe për pasojë nuk merret në shqyrtim nga KAS. KAS është kompetent për ankesat ndaj vendimit për shpalljen e rezultatit dhe jo për ankesat ndaj vendimeve të KZAZ-ve të veçanta.

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja "b", të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve", kërkesa ankimore nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja "b" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 64, datë 20.05.2023, të paraqitur nga Partia Lëvizja e Legalitetit.

2. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot, më datë 22.05.2023

Elvin	LAKO	-	Relator
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar